INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

AMERICAN HERITAGE
UNIVERSITY
OF SOUTHERN CALIFORNIA

# REGJISTRIMET 2025

19 VITE HISTORI SUKSESI

NJOHJE NDËRKOMBËTARE E DIPLOMËS

BURSA MERITORE DHE SOCIALE

MOBILITET ME PROGRAMIN ERASMUS+ dhe partneritet me mbi 100 universitete ndërkombëtare

MUNDËSI PUNËSIMI GJATË STUDIMEVE

www.iust.edu.mk

# Çfarë mund të studioni në UNS?

| | |
|---|---|
| Ekonomi dhe biznes | - Ekonomi dhe Biznes (3+2 ose 4+1)<br>- Marketing dhe Menaxhim Financiar(3+2) |
| Inxhinieri kompjuterike | - Shkenca Kompjuterike (3+2)<br>- Inxhinieri Softueri (3+2) |
| Drejtësi | - Jurisprudencë (3+2)<br>- Kriminalistikë dhe detektiv (3+2 ose 4+1) |
| Shkenca politike | - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci (3+2) |

## Fjala e Rektorit!



Të dashur maturantë !

Le të jetë zgjedhja juaj për këtë vit akademik 2025-2026, Universiteti Ndërkombëtar Strugë, në qytetin e bukur të Strugës, buzë liqenit të Ohrit, në Maqedoninë e Veriut.

Një universitet privat , me një përvojë 18 vjeçare, me katër fakultete, në të cilin janë diplomuar me mijëra studentë nga Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova, Lugina e Preshevës dhe Ulqini por edhe nga shtete të tjera.

Diploma që ju do të merrni, është e njohur jo vetëm në të gjitha shtetet e Ballkanit, por edhe në Europë dhe SHBA me një nga universitetet e të cilës ne ofrojmë edhe diploma të dyfishta.

Kampuset universitare pranë liqenit , vendosur në një zone të qetë të qytetit tonë, ofrojnë për ju, jo vetëm kushte të mira mësimi por edhe shëndeti.

Profesorët tanë janë jo vetëm mësimdhënës të aftë, por edhe kërkues shkencor apo drejtues institucionesh të rëndësishëm në nivel kombëtar në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

Biblioteka jonë e pasur ofron për ju çdo libër që ju duhet për leksione si literaturë kryesore apo si reference shtesë. Në bibliotekë dhe jo vetëm , ju do të organizoni aktivitete të shumta studentore me autorë dhe personalitete të shquara.

Përveç katër fakulteteve ne kemi edhe dy institute kërkimore shkencore që mbajnë emrat e dy personaliteteve të shquara shqiptare nga Tirana si : Instituti për Europianistikë dhe Politikë Ndërkombëtare "Luan Hajdaraga" dhe Instituti për Zhvillim Ekonomik dhe Menaxhim Mjedisor " Bashkim Rama" në të cilën studentët krahas pedagogëve mund të angazhohen në projekte kërkimore dhe veprimtari të shumta publike.

Studentët, të cilët njohin mirë gjuhën angleze, do të kenë mundësi të studiojnë një semester në një nga universitetet europiane.

Të nderuar prindër !

Besimi juaj është përgjegjësi e lartë për ne. Ne jemi mësimdhënës por edhe prindër dhe e kuptojmë nevojën dhe merakun tuaj. Ne do të kujdesemi njëlloj si ju, ne do të jemi në kontakt të vazhdueshëm me ju dhe do tju përgjigjemi sa herë që ju do të keni nevojë të informoheni për ecurinë e fëmijëve tuaj apo edhe punësimin e tyre kur është e mundur.

Ju mirëpresim !

**Prof.Dr. Shpëtim Cami**
Rektor i Universitetit Ndërkombëtar Strugë, Maqedoni e Veriut







## Qyteti ku natyra, kultura dhe ritmi i gjallë i jetës krijojnë atmosferën perfekte

Struga është një qytet i bukur dhe historik, i cili gjendet në bregun verior të Liqenit të Ohrit, në juglindje të Maqedonisë s; Veriut. Ky destinacion turistik është një perlë e fshehur e Ballkanit, e njohur për peizazhet e saj të mrekullueshme dhe trashëgiminë kulturore të pasur.

Liqeni i Strugës, i cili është një nga liqenet më të vjetra në Evropë, shton bukurinë e këtij qyteti. Ujërat e këtij liqeni janë të kthjellëta duke ofruar kështu një ambient të mrekullueshëm për tu rizëm dhe jo vetëm.

Struga është e njohur gjithashtu për festivalin e saj të njohur ndërkombëtar, "Mbrëmjet e poezisë", ku poetë nga e gjithë bota mblidhen për të ndarë poezi dhe për të festuar artin e fjalës. Ky festival bën që Struga të jetë një destinacion kryesor për miqtë e letërsisë dhe artit.

Me një atmosferë të qetë dhe të bukur, Struga është një destinacion i mrekullueshëm për ata që dëshirojnë të eksplorojnë bukurinë dhe historinë, njëkohësisht kjo e bën këtë qytet një ambient të përshtatshëm për studime.






## Kampus me kushte dhe teknologji bashkëkohore

Në Universitetin Ndërkombëtar në Strugë do të gjeni ambiente komode për të studiuar sipas standarteve më të larta bashkëkohore universitare.

Ambientet në UNS janë të krijuara posaçërisht për studentët të cilët zgjedhin të studiojnë në institucionin tonë , pasi të kujdesesh për studentin është qëllimi ynë primar.

Studentët që studiojnë në UNS kanë mundësi të ndjekin ligjeratat dhe seminaret në salla të mëdha dhe moderne të pajisura me mjete audio – vizive, në mënyrë që studenti të ndihet sa më komod ,sa më i fokusuar dhe i përqëndruar në procesin e studimit.

# Përfitoni diplomë të dyfishtë amerikane!

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë është i përkushtuar për të ofruar arsim cilësor dhe mundësi të jashtëzakonshme për studentët e tij, duke i ndihmuar ata të arrijnë standarde ndërkombëtare në arsimim dhe karrierë. Në këtë drejtim, UNS ka krijuar një partneritet strategjik me American Heritage University of Southern California, duke u mundësuar studentëve të fitojnë një Diplomë të Dyfishtë (Dual Degree) të vlefshme ndërkombëtarisht.

Ky program ofron një shans të artë për studentët që kanë arritur rezultate të larta akademike dhe që plotësojnë kriteret përkatëse, për të marrë një diplomë të dytë nga një universitet prestigjioz në SHBA. Diploma e dyfishtë vjen e certifikuar me vulën apostile, e cila garanton vlefshmërinë e saj në çdo vend të botës. Kjo diplomë jo vetëm që pasuron profilin akademik të studentëve, por gjithashtu u hap atyre dyert për të vazhduar studimet master në universitetet e SHBA-së, duke zgjeruar kështu mundësitë për zhvillim të mëtejshëm profesional dhe personal.

E veçanta e këtij bashkëpunimi është se studentët nuk kanë asnjë kosto shtesë për të përfituar këtë diplomë, përveç përkushtimit ndaj rezultateve të tyre akademike dhe përmbushjes së kushteve të nevojshme. Kjo e bën këtë iniciativë të përballueshme dhe tejet atraktive për të gjithë ata që dëshirojnë të ndjekin ambiciet e tyre ndërkombëtare.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, studentët përfitojnë edhe certifikata ekuivalente të notave sipas sistemit amerikan të vlerësimit, duke u njohur dhe vlerësuar puna e tyre akademike në standarde të nivelit të lartë. Ky është një tregues i përkushtimit të UNS-së për të përgatitur studentët për sfidat e tregut global të punës dhe të akademisë.

Në kuadër të bashkëpunimit me American Heritage University, UNS ka prodhuar histori suksesi ku shumë studentë të dalluar kanë shfrytëzuar këtë mundësi për të ndërtuar karriera të suksesshme në Ballkan, Europë dhe SHBA.




INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

AMERICAN HERITAGE
UNIVERSITY
OF SOUTHERN CALIFORNIA

















# Gjatë pushimeve verore mund të punoni në SHBA

Universiteti Ndërkombëtar, duke pasur në qendër të vëmendjes zhvillimin profesional dhe personal të studentëve, ofron një mundësi unike përmes programit Work and Travel. Ky program është krijuar për të mbështetur studentët e studimeve deridiplomike dhe postdiplomike, duke u ofruar atyre një eksperiencë të paharrueshme jashtë vendit.

Work and Travel lejon studentët të punojnë dhe të qëndrojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Angli ose Gjermani gjatë pushimeve verore. Ky është një rast i veçantë për ta që të ndërveprojnë me kultura të reja dhe të përfitojnë përvoja të rëndësishme në tregun e punës ndërkombëtar. Përmes këtij programi, studentët fitojnë jo vetëm të ardhura të konsiderueshme financiare, por gjithashtu krijojnë lidhje të vlefshme me bizneset dhe profesionistët ndërkombëtarë.

Një nga përfitimet më të mëdha të programit është mundësia për të përvetësuar gjuhën angleze. Puna dhe jetesa në një mjedis ku gjuha angleze është e domosdoshme u mundëson studentëve të përmirësojnë aftësitë gjuhësore në mënyrë të natyrshme dhe të shpejtë. Për më tepër, kontakti me njerëz nga vende dhe kultura të ndryshme ndihmon studentët të zhvillojnë një perspektivë më të gjerë globale dhe t'i kuptojnë më mirë diversitetet kulturore.

Programi Work and Travel është një mundësi ideale për të ndërtuar marrëdhënie të reja miqësore me studentë nga e gjithë bota. Përmes këtij rrjetëzimi ndërkombëtar, studentët kanë mundësinë të krijojnë lidhje të qëndrueshme, të cilat mund të jenë shumë të vlefshme për të ardhmen e tyre profesionale.

Universiteti Ndërkombëtar luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin e pjesëmarrjes së studentëve në këtë program. Ai ofron udhëzime për aplikim, këshilla për përgatitjen për udhëtimin dhe ndihmë për të gjetur punë të përshtatshme. Për më tepër, universiteti bashkëpunon me agjenci të njohura që garantojnë një përvojë të sigurt dhe të suksesshme.

Work and Travel është një mundësi që shkon përtej thjesht punësimit sezonal. Ai është një eksperiencë e gjithanshme që kombinon zhvillimin profesional, pasurimin kulturor dhe zgjerimin e horizonteve personale. Universiteti Ndërkombëtar, duke ofruar këtë mundësi, i ndihmon studentët të bëhen më të përgatitur për tregun global të punës dhe të kenë një vizion më të gjerë për të ardhmen.

Era Vavla - Berat

Eksperienca ime në Work and Travel



Gjatë studimeve për master në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, pata mundësinë të isha pjesë e programit Work&Travel. Falë këtij programi, vizitova Statujen e Lirisë në New York dhe Universitetin e Harvardit në Boston, dy vende që i kam pasur gjithmonë ëndërr.

Përveç këtyre, eksplorova shumë vende të tjera dhe munda të njoh kulturën e SHBA-së, si dhe të takoj shumë të rinj. Kjo eksperiencë ishte e jashtëzakonshme dhe kontribuoi në zgjerimin e perspektivave të mia kulturore dhe shoqërore.

# Programi ERASMUS+ dhe mundësitë e tij të shkëlqyera për studentët e UNS-së



Emanuela Oruçi
Eksperienca ime në Erasmus+

Pjesëmarrja ime në programin Erasmus+ në Universitetin Ni anta në Stamboll ishte një ndër përvojat më të veçanta dhe frytdhënëse në jetën time. Kjo mundësi më hapi dyer drejt një aventure të paharruar, ku u kombinuan arsimimi cilësor, kultura e pasur dhe një përvojë personale transformuese.
Një nga aspektet më të veçanta të eksperiencës ishte diversiteti kulturor i kampusit. Takova studentë nga vende të ndryshme të botës, të cilët ndanin historitë dhe kulturat e tyre. Ndërveprimi me ta jo vetëm që më pasuroi në aspektin personal, por gjithashtu më ndihmoi të kuptoj perspektiva të ndryshme që janë jashtëzakonisht të vlefshme në një botë gjithnjë e më të globalizuar. Përveç miqve ndërkombëtarë, kisha edhe mundësinë të lidhesha me studentë lokalë, të cilët më prezantuan më nga afër kulturën dhe traditat turke.

Programi Erasmus+ është një nga iniciativat më të njohura të Bashkimit Evropian, që synon të promovojë arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin në të gjithë Evropën dhe më gjerë. Ky program ofron mundësi të jashtëzakonshme për studentët e universiteteve, përfshirë edhe studentët e Universitetit Ndërkombëtar në Strugë, për të zhvilluar aftësitë e tyre akademike, profesionale dhe personale përmes shkëmbimeve ndërkombëtare.

Erasmus+ mbështet mobilitetin e studentëve për të studiuar ose për të bërë praktikë në një vend të huaj. Kjo mundësi është një derë e hapur drejt një eksperience ndërkombëtare, që jo vetëm zgjeron horizontet kulturore, por gjithashtu përgatit studentët për një treg pune gjithnjë e më global. Për studentët e Universitetit Ndërkombëtar në Strugë, pjesëmarrja në këtë program është një mundësi unike për të përfituar nga cilësia e arsimit në vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

Një nga përfitimet kryesore të Erasmus+ është mundësia për të ndjekur një semestër ose një vit akademik në një universitet partner ndërkombëtar. Studentët kanë mundësinë të ndjekin kurse që ndoshta nuk janë të disponueshme në universitetin e tyre amë, duke përfituar nga teknologjitë dhe metodat e avancuara të mësimdhënies. Ky proces jo vetëm që pasuron njohuritë akademike, por ndihmon edhe në zhvillimin e aftësive ndërkulturore, si komunikimi dhe bashkëpunimi me studentë nga kultura të ndryshme.

Gjithashtu, Erasmus+ ofron mbështetje financiare për studentët pjesëmarrës. Kjo mbështetje mbulon një pjesë të shpenzimeve për jetesë dhe udhëtim, duke bërë që mobiliteti ndërkombëtar të jetë i përballueshëm për një gamë të gjerë studentësh. Për studentët e Universitetit Ndërkombëtar në Strugë, kjo është një mundësi për të eksploruar botën pa u shqetësuar për barrën financiare.

Një tjetër përfitim i rëndësishëm i këtij programi është mundësia për të zhvilluar praktika profesionale jashtë vendit. Përmes këtyre praktikave, studentët fitojnë përvojë të drejtpërdrejtë në fusha të ndryshme, duke rritur kështu shanset për të gjetur punë pas diplomimit. Përveç kësaj, një eksperiencë ndërkombëtare në CV është një avantazh i madh për çdo aplikim pune.

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë ka një angazhim të fortë për të mbështetur studentët e tij në përfitimin maksimal nga programi Erasmus+. Nëpërmjet marrëveshjeve me universitete partnere dhe mbështetjes administrative, studentëve u krijohet një platformë e qartë dhe e thjeshtë për të aplikuar dhe për të përfituar nga ky program.

Përveç përfitimeve akademike dhe profesionale, pjesëmarrja në Erasmus+ ndihmon studentët të zhvillojnë personalitetin e tyre. Jeta në një vend të ri, larg komfortit të shtëpisë, i sfidon studentët të bëhen më të pavarur, të zgjidhin problemet në mënyrë kreative dhe të përballojnë situata të reja me vetëbesim.



Xhemail Maksuti
Eksperienca ime në Erasmus+

Pjesëmarrja ime në programin Erasmus+ në Turqi ishte një përvojë që do ta kujtoj gjatë gjithë jetës. Ky program më dha mundësinë të udhëtoj dhe të studioj në një vend të pasur me kulturë dhe histori, duke më ofruar eksperienca të shumta që më ndihmuan të zhvillohem si në aspektin personal ashtu edhe në atë profesional. Në Stamboll, një qytet që është kryqëzim mes Lindjes dhe Perëndimit, pata fatin të njihem me studentë nga kultura të ndryshme dhe të shkëmbejmë ide, përvoja dhe tradita. Ky diversitet kulturor më ndihmoi të kuptoj më mirë perspektiva të reja dhe të zhvilloj aftësi ndërkulturore, të cilat janë shumë të rëndësishme në botën e sotme globale.



Sema Kadriu
Eksperienca ime në La Sapienza

Unë zgjodha të realizoja mundësinë e shkëmbimit studentor që na ofron programi ERASMUS+ në Romë, në Universitetin prestigjioz La Sapienza. Ishte një përvojë shumë e rëndësishme dhe frymëzuese, që kontribuoi ndjeshëm në zhvillimin tim profesional dhe personal. Gjatë qëndrimit tim në këtë universitet të njohur ndërkombëtarisht, pata mundësinë të ndjek kurse të avancuara dhe të përfshihem në aktivitete praktike që pasuruan njohuritë e mia akademike. Përveç kësaj, jeta në një qytet historik si Roma më dha mundësinë të përjetoja një diversitet kulturor të pasur dhe të krijoja lidhje të reja me studentë nga vende të ndryshme. Kjo është një eksperiencë që do t'ua sugjeroja të gjithë kolegëve të mi në UNS, sepse është një mundësi unike për t'u zhvilluar dhe për të krijuar kujtime të paharruara.

Erasmus+
This project has been funded with support from the European Commission.

MCI ( Management Center Innsbruck )-ishte nje nga zgjedhjet e mia të drejtimit Master dhe falë bashkëpunimit nëpërmjet UNS dhe MCI përfitova 50% bursë .

Faleminderimi shkon për UNS i cili më ka ofruar një mbështetje të madhe gjatë këtyre tre viteve të studimit dhe falë mbështetjes së saj ëndërra ime për të vazhduar studimet Master në Austri u bë e mundur.

Suksesi im është rezultat i punës së palodhur të stafit akademik të UNS ,të cilët na ofrojnë një mbështetje të jashtëzakonshme në rrugëtimin tonë.

Lorena Ilazaj
Eksperienca ime në Universitetin e Salzburgut



# Mundësi të shumëfishta me programin për shkëmbim studentor

Edukimin dhe formimin tim ia besova Universiteti Ndërkombëtar në Strugë. Falë mbështetjes së stafit akademik dhe përgatitjes që mora në Universitetin Ndërkombëtar në Strugë pata mundësi të zgjedhja të studioja master në një nga universitetet partnere të Universitetit Ndërkombëtar në Strugë.

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë ka qenë për mua një mbështetje gjatë studimeve dhe pas studimeve. Aktualisht punoj si juriste në Data Privacy dhe Data Protection, në një ndër kompanitë e para të specializuara në GDPR! Gjithmonë mirënjohëse ndaj Universitetit Ndërkombëtar në Strugë dhe stafit akademik të UNS!



Borana Qytyku
Eksperienca ime në MCI Insbruck Austri

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë është një institucion arsimor i cili vazhdimisht investon në krijimin e mundësive ndërkombëtare për studentët e tij. Një nga programet më të rëndësishme që UNS ofron është ai për shkëmbimin e studentëve, një iniciativë që synon të hapë dyert për përvoja akademike dhe kulturore në mbarë botën.

Përmes marrëveshjeve me mbi 100 universitete ndërkombëtare, kryesisht në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, UNS u ofron studentëve të tij një platformë të jashtëzakonshme për të ndjekur një pjesë të studimeve jashtë vendit. Këto marrëveshje bashkëpunimi lejojnë që studentët të transferojnë kreditet akademike të fituara në universitetet partnere, duke siguruar një tranzicion të lehtë dhe pa probleme në procesin e tyre arsimor.

Shkëmbimi i studentëve përmes UNS u mundëson pjesëmarrësve të përfshihen në sisteme të ndryshme arsimore dhe të ndjekin kurse që ndoshta nuk janë të disponueshme në universitetin e tyre. Kjo përvojë ndihmon studentët të zhvillojnë njohuri të reja dhe të zgjerojnë në fushën e tyre të studimeve, ndërkohë që përmirësojnë aftësitë e tyre të të menduarit kritik dhe të adaptimit në mjedise të ndryshme akademike.

Përveç përfitimeve akademike, studentët përfitojnë edhe nga një shkëmbim kulturor që u lejon të mësojnë për zakone, gjuhë dhe tradita të reja. Njohja me studentë nga vende të ndryshme rrit aftësinë për të bashkëpunuar në mënyrë ndërkulturore dhe përgatit studentët për një treg pune gjithnjë e më global.

Një tjetër përfitim i madh i këtij programi është mundësia për të vazhduar studimet pasuniversitare (master) në një nga universitetet partnere. Përmes UNS, studentët kanë akses në informacione dhe mbështetje për të aplikuar për programe master jashtë vendit. Shumë prej universiteteve partnere ofrojnë bursa të plota ose të pjesshme për studentët ndërkombëtarë, duke i bërë këto programe të përballueshme financiarisht.

Kjo mundësi është veçanërisht e rëndësishme për studentët që synojnë të avancojnë në karrierën e tyre akademike ose profesionale. Duke studiuar në një universitet ndërkombëtar me bursë, studentët jo vetëm që marrin një arsim cilësor, por gjithashtu ndërtojnë një rrjet të gjerë kontakti dhe zhvillojnë aftësi të vlefshme për tregun global të punës.

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë ofron mbështetje të plotë për studentët e tij gjatë gjithë procesit të shkëmbimit. Qendrat për marrëdhënie ndërkombëtare dhe zyrat administrative të universitetit ndihmojnë studentët në përzgjedhjen e programeve të duhura, përgatitjen e dokumentacionit dhe orientimin përpara nisjes së tyre.

Përveç kësaj, UNS organizon takime informuese dhe aktivitete për të siguruar që çdo student të jetë i përgatitur për përfitimet që sjell një eksperiencë ndërkombëtare.

# KRIMINALISTIKË DHE DETEKTIV

UNS zhvillon trajnimet në drejtimin Kriminalistikë dhe Detektivë në: Sallën trajnuese dhe Qendrën e Kriminalistikës të UNS , e cila ka vendndodhjen në një zonë të pabanuar dhe është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme, që nga pajisjet mbrojtese dhe taktike, deri te standardet IPSC (International Practical Shooting Confederation) dhe armatimi i NATO-s, me standarde brenda masave të sigurisë. Praktika Kriminalistike është një nga kërkesat e detyrueshme për studentët e drejtimit Kriminalistikë dhe Detektivë në UNS. Aftësimi dhe më pas vlerësimi i studentëve, sjellin student të formësuar shkencërisht dhe fizikisht.

















# Mundësi të shumëfishta punësimi pas diplomimit në Kriminalistikë dhe Detektiv

Programi Kriminalistikë dhe Detektiv paraqet një mundësi të shumëfishte punësimi për studentët të cilët diplomohen në këtë program. Përgatitja që marrin studentët gjatë studimeve të tyre u mundëson atyre që jenë të suksesshëm në karrierën që ndjekin në vazhdim.

Këto trajnime zhvillohen në drejtim të përgatitjes së tyre intelektuale, fizike dhe profesionale, duke kombinuar brenda programit pjesën e sudimit, praktikës studimore, ushtrimeve fizike, punës në labotratorin special të kriminalistikës, përgatitjes specifike profesionale (praktikë të qitjes me armë, logorim, karate, xhudo, etj.).













# Aktivitete të shumëllojshme studentore

Aktivitetet studentore janë një detaj mjaft rëndësishëm, përsa i përket përfshirjes së studentëve në organizime të ndryshme kulturore,sociale, politike. Universiteti Ndërkombëtar në Strugë së bashku me grupet e studentëve kanë ndërrmarë një larmishmëri aktivitetesh, të cilat kanë ndikuar në reflektimin e tyre për problematika në fushën e drejtësise,ekonomisë dhe të teknologjisë informative.

Aktivitetet studentore janë një pjesë e pandarë e programeve që ofron UNS. Disa nga eventet të cilat spikasin janë takime të ndryshme me ambasadorë/deputetë dhe personazhe të ndryshem të cilët janë pjesë e elitës së shoqërisë,shkembime studentore në shtete/institucione të ndryshme me të cilat UNS ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi.







# Tarifa e studimit

Tarifa vjetore për studimet bachelor në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës (UNS) është 1920 euro. Kjo tarifë përfshin një gamë të gjerë shërbimesh dhe përfitimesh për studentët, duke e bërë procesin e studimit më të lehtë dhe të përballueshëm.

Në kuadër të kësaj tarife përfshihen:

Librat dhe skriptet e nevojshme për lëndët akademike, si dhe materiale të tjera studimore.
Shërbimet akademike dhe administrative, duke përfshirë asistencën gjatë gjithë periudhës së studimeve.
Paraqitja e provimeve, duke eliminuar kosto shtesë për këtë proces.

Përveç këtyre, UNS synon të sigurojë një përvojë cilësore studimi, duke përfshirë qasje në burime të reja mësimore dhe shërbime mbështetëse që kontribuojnë në suksesin akademik të çdo studenti. Kjo tarifë është një investim i plotë në edukimin dhe përgatitjen profesionale të studentëve.

## Akomodimi falas



Tarifa e studimit për një vit akademik, për të gjitha drejtimet e studimit (Bachelor) është:

1920
(12 këste nga 160 në muaj)



Universiteti Ndërkombëtar në Strugë, në bashkëpunim me bizneset lokale që operojnë në qytetin e Strugës, ofron mundësi të shkëlqyera punësimi për të gjithë studentët që dëshirojnë të punojnë gjatë periudhës së studimeve. Kjo iniciativë synon të ndihmojë studentët të balancojnë kërkesat akademike me nevojat financiare, duke ofruar një zgjidhje të përshtatshme për të lehtësuar buxhetin e tyre.

Puna gjatë studimeve jo vetëm që përmirëson stabilitetin financiar të studentëve, por gjithashtu u jep atyre mundësinë për të fituar përvojë praktike dhe aftësi të vlefshme profesionale që do t'i ndihmojnë në zhvillimin e tyre të ardhshëm.

Universiteti ndihmon studentët të zgjedhin nga një gamë e gjerë pozicionesh pune, të përshtatura sipas interesave dhe nevojave të tyre. Për të lehtësuar këtë proces, studentët njoftohen rregullisht për konkurset e reja të punës nëpërmjet emailit zyrtar.

Kjo iniciativë reflekton përkushtimin e Universitetit Ndërkombëtar në Strugë për të mbështetur studentët jo vetëm në arsimimin e tyre, por edhe në ndërtimin e një baze solide për karrierën dhe të ardhmen e tyre profesionale.

## Mundësi punësimi për çdo student gjatë studimeve



Lusjana Naçi

Një përparësi e UNS-së është se ofron mundësi punësimi për të gjithë studentët përgjatë gjithë kohës së studimeve e cila është një mundësi mjaftë e mirë për të mbuluar shpenzimet.

## Programi WORK & STUDY



Denisa Hani

Unë kam nderin të kem perfituar edhe nga Programi "Work and Study" që ky Universitet prestigjioz ofron, ku aktualisht jam duke ndjekur studimet Master, por jam edhe pjese e stafit.



Fiona Hamzallari

Unë jam studente e UNS-së prej gati tashme nje viti dhe perfituese e burses qe jepet prej universitetit ne ndihme te studenteve te tij. Une kam fituar burse meritore prej 70%.



Marilda Lulaj

Mund të them me plot bindje që ka qenë një eksperinecë fantastike dhe kam besimin se kështu do të vazhdojë të jetë. E gjitha kjo falë një stafi tepër profesional dhe të kualifikuar.



Jonila Rrahmani

Ishte e veshtire te zgjedh se ku do te studioj.Nga nje vendim qe do merrja,do varej suksesi im,pas nje hamendje vendosa te zgjedh UNS-ne.
UNS ka nje staf te pergatitur mjaft mire dhe te perkushtuar qe na gjendet gjithmone prane dhe na inkurajojne per te vazhduar me tej.
Une si studente e drejtimit "Ekonomi dhe biznes" mendoj se UNS eshte zgjedhja e duhur per te ndricuar te ardhmen!




## 100 bursa meritore dhe sociale për maturantët e vitit 2025

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë vazhdon edhe këtë vit të mbështesë maturantët përmes ndarjes së bursave të dy kategorive kryesore: bursa meritore dhe bursa sociale.

Bursat meritore janë të dedikuara për maturantët me sukses të lartë gjatë katër viteve të shkollës së mesme. Bursat sociale janë të hapura për maturantët që përballen me sfida financiare, si dhe ata që nuk e kanë njërin ose të dy prindërit, duke synuar t'u lehtësojnë barrën financiare të shkollimit. Përveç këtyre kategorive kryesore, bursat ofrojnë nën-kategoritë që mundësojnë lehtësime të ndryshme në pagesën e shkollimit. Vlera e bursës mund të shkojë nga një zbritje e pjesshme deri në lirim të plotë nga detyrimi për pagesën e shkollimit, duke siguruar mbështetje të personalizuar për nevojat e secilit student.

Këto bursa janë një shembull i angazhimit të Universitetit për të garantuar arsimim cilësor dhe të arritshëm për të gjithë studentët, pavarësisht sfidave të tyre ekonomike.

# Aplikimi bëhet online në web faqen e universitetit!

**1. Kliko linkun - www.iust.edu.mk**




**2. Kliko - Apliko tani**

**3. Plotëso formularin**

(*kujdes! jepni e-mail të vlefshëm)




**4. Do të pranoni e-mail nga administrata per pranimin e aplikimit tuaj**

## Kontakt

Ezerski Lozja 1,Struga 6330, R. e Maqedonisë së Veriut

www.iust.edu.mk

info@eust.edu.mk

+389 46 786 160

+389 76 370 505

facebook.com/ius.edu

internationaluniversity_struga

Skano për më
shumë informacion